



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.110

18 korrik

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK nr.17, datë 19.6.2009	Me objekt: Shfuqizimi i vendimit nr.1282, datë 9.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën..... 2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.179, datë 10.4.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës.....	5335
Vendim i BSH nr.44, datë 10.6.2009	Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”	5338
Vendim i BSH nr.45, datë 10.6.2009	Për miratimin e rregullores “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”	5348
Vendim i BSH nr.46, datë 10.06. 2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”	5352
Vendim i BSH nr.47, datë 10.6. 2009	Për një shtesë në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”	5358
Vendim i KKRT nr.858, datë 12.6.2009	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Glob Tv”	5358
Vendim i KKRT nr.859, datë 12.6.2009	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Rex”	5359
Vendim i KKRT nr.860, datë 12.6.2009	Për zgjerim zone licencimi për radion private vendore “B-94”	5359
Vendim i KKRT nr.861, datë 12.6.2009	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio 1” ...	5360

Vendim i KKRT nr.862, datë 12.6.2009	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio 108”	5360
Vendim i KKRT nr.863, datë 12.6.2009	Për dhënie licence për radion private vendore “Scan”	5361
Vendim i KKRT nr.864, datë 12.6.2009	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV Kombi”.....	5361
Vendim i KKRT nr.865, datë 12.6.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Alpo”	5362
Vendim i KKRT nr.866, datë 12.6.2009	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV Kabllor Lushnja”	5362
Vendim i KKRT nr.868, datë 12.6.2009	Për dhënie licence për platformën private numerike satelitore “Tring TV”, subjektit “Tring TV” sh.a.....	5363

VENDIM
Nr.17, datë 19.6.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 20.1.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30/15 Akti që i përket:

KËRKUES: Agim Karazi, Ora Karazi, Petrit Karazi, Luljeta Karazi, Donika Karazi, të përfaqësuar nga av. Roland Samarxhi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. Bukurie Kazazi, Ikbale Kazazi, Ildir Kazazi, Aurora Kazazi, Ardian Kazazi, Aida Kazazi dhe Artur Velaj, në mungesë.

2. Rifat Kazazi, përfaqësuar nga av. Agim Hoxha, me prokurë.

3. Zyra rajonale e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Durrës, në mungesë.

4. Bashkia Durrës, në mungesë.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.1282, datë 9.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.179, datë 10.4.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 27, 28, 45 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkesve, që kërkoj pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjekteve të interesuara, që kërkoj rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesit, trashëgimtarë ligjorë të shtetasit Hamdi Sulejman Karazi, u janë drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) pranë bashkisë Durrës, duke kërkuar njohjen pronarë dhe kthimin e një sipërfaqeje toke prej 5068 m², ndodhur në parcelën 45, në plazhin e Durrësit, me pretendimin se kjo pronë ka qenë në pronësi të trashëgimlënësit të tyre dhe i është shtetëzuar këtij të fundit në vitin 1946. Me vendimin nr.587, datë 12.9.2000, KKKP Durrës ka rrëzuar kërkesën e paraqitur nga Agim Karazi etj., me arsyetimin, se me vendimin nr.386, datë 22.3.1994, kjo sipërfaqe toke u është njohur në pronësi dhe u është kthyer trashëgimtarëve të Hamdi Sefer Kazazit (subjekte të interesuara). Në këto kushte, kërkuesit Karazi u janë drejtuar me padi gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar anulimin e vendimit të KKKP Durrës dhe detyrimin e të paditurve të njohin paditësit pronarë mbi sipërfaqen e truallit prej 5068 m².

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr.1235, datë 30.5.2005 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke anuluar vendimin nr.386, datë 22.03.1994 të KKKP Durrës, dhe detyrimin e të paditurve të njohin paditësit pronarë mbi sipërfaqen e truallit objekt gjykimi.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.179, datë 10.04.2006 ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësve Agim Karazi etj.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.1282, datë 9.11.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse Agim Karazi etj., me arsyetimin, se rekursi është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 443/2 i Kodi i Procedurës Civile.

Kërkuesit pretendojnë se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është jokushtetues dhe kërkojnë shfuqizimin e tij, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili e ka konsideruar rekursin si jashtë afatit, u ka cenuar atyre të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës. Rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit është depozituar në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, më datë 8.5.2006, pra brenda afatit ligjor. Ky fakt provohet me vulën dhe nënshkrimin e sekretarisë së kësaj gjykate, kurse data e kopjes së rekursit që ka shoqëruar dosjen gjyqësore në Gjykatën e Lartë është ndryshuar, duke u shtuar numri “1” para datës 8 maj.

Përfaqësuesi i subjekteve të interesuara Kazazi kërkoi përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar se:

- Në lidhje me pretendimin për falsifikimin e mundshëm të datës së rekursit është regjistruar një procedim penal dhe është organi i prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës që do të saktësojë ekzistencën ose jo të këtij falsifikimi. Edhe në rast se do të provohet ky falsifikim, Gjykata Kushtetuese nuk është organi kompetent për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi kërkuesi duhet të konsumojë shkallët e gjykimit dhe t'i drejtohet Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së prerë, bazuar në nenin 494/ç të Kodit të Procedurës Civile.

II

1. Lidhur me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë

Në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në fillim të seancës plenare, Gjykata Kushtetuese dëgjoi pretendimet e palëve për kërkimin që lidhet me pezullimin e vendimit nr.179, datë 10.4.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës. Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese konstatoi, se nga ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar nuk vijnë pasoja nga ato që kërkon dispozita e mësipërme e ligjit nr.8577.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, si të pabazuar.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim duhet të shqyrtohet në kuadër të standardeve të procesit të rregullt ligjor, të sanksionuara nga neni 42 i Kushtetutës, konkretisht në drejtim të respektimit nga Gjykata e Lartë të së drejtës së individit për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit).

Gjykata Kushtetuese thekson, se nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, buron e drejta e kujtdo, që pretendon se të drejtat ose liritë e tij janë cenuar, për një gjykim të drejtë përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj; që kjo e drejtë nuk mund të kufizohet artificialisht dhe që zbatimi i saj nuk duhet të pengohet në mënyrë të paarsyeshme; që e drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë apo institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht.

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), si një nga aspektet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 11.5.1006). Këto dispozita sanksionojnë në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 6.3.2009*).

Gjykata Kushtetuese thekson, se garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor janë të zbatueshme edhe në gjykimin përpara Gjykatës së Lartë. Edhe Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut, në vendimet e saj ka theksuar, se neni 6 i KEDNJ nuk i detyron shtetet kontraktuese të krijojnë gjykata apeli apo kasacioni. Megjithatë, sipas opinionit të kësaj gjykate (Gjykatës së Strasburgut), një shtet i cili i krijon këto gjykata, duhet të sigurojë që personat subjekt i ligjit, të gëzojnë përpara këtyre gjykatave garancitë themelore të përfshira në nenin 6 (*shih vendimet e GJEDNJ, çështja Marini v. Albania, datë 18.12.2007, par.120; çështja Delcourt v. Belgium, datë 17.1.1970, par. 25*).

Gjykata Kushtetuese, mbështetur në jurisprudencën e saj të konsoliduar, thekson, megjithatë, se këto mjete mbrojtëse (pra, mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e individit) duhet të përdoren brenda afateve ligjore. Përcaktimi i këtyre afateve ka për qëllim respektimin e parimit të sigurisë juridike, si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 10.11.2006). E drejta e aksesit në gjykatë, ashtu si dhe e drejta e ankimit, si të drejta kushtetuese, mund t'u nënshtrohen kufizimeve deri në atë masë sa të mos cenojnë thelbin e këtyre të drejtave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 15.12.2008; nr.19, datë 23.12.2004*).

Në çështjen objekt shqyrtimi, kërkuesit pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi nuk ka pranuar për gjykim një rekurs të paraqitur brenda afatit ligjor. Sipas tyre, rekursi është paraqitur në Gjykatën e Lartë në datën 8 maj dhe jo në datën 18 maj, siç arsyeton kjo gjykatë. Për të provuar pretendimet e tyre, kërkuesit kanë paraqitur shkresën nr.240 prot., datë 14.2.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas së cilës "*rekursi i paraqitur nga paditësit Agim Karazi etj., është depozituar në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës më datën 8.5.2006*". Edhe në rekursin e depozituar nga kërkuesit në Gjykatën Kushtetuese, nga sekretaria gjyqësore është e shënuar si datë e paraqitjes së tij data 8.5.2006, ndërkohë që në kopjen e rekursit të administruar në dosjen e dërguar në Gjykatën e Lartë, rezulton si datë e depozitimit të rekursit data 18.5.2006.

Për të verifikuar pretendimin e mësipërm, përveç dokumenteve të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese i'u drejtua me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit, me shkresën nr.1196 prot., datë 17.10.2008, ka dërguar bashkëlidhur një kopje të fletës së regjistrimit të ankimeve, nga i cili rezulton si datë e paraqitjes së rekursit data 8.5.2006. Përveç kësaj, mbi bazën e pretendimeve të bëra në seancë gjyqësore për vazhdimin e një procedimi penal për falsifikim, në lidhje me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese i'u drejtua me shkresë prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo e fundit, me shkresën nr.923/1 prot., datë 16.2.2009, në mënyrë të përmbledhur, njofton se gjatë hetimit të këtij procedimi, nga ekspertimi grafik, ka rezultuar, se "*në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë me nr.25/0 akti, datë 7 maj 2006, në shënimin "u paraqit 18.5.2006" të vendosur në faqen e parë të rekursit, numri "1" përpara numrit "8" është shkruar me mjet shkruar tjetër nga ai me të cilin është shkruar pjesa tjetër e dorëshkrimit*". Nëpërmjet kësaj shkrese, organi i prokurorisë njofton gjithashtu, se meqenëse nuk është bërë e mundur të përcaktohet autori i veprës penale, me vendimin datë 26.1.2009 të prokurorit, është pezulluar ky procedim penal.

Duke pasur parasysh tërësinë e rrethanave të mësipërme, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga pala kërkuese është brenda afatit ligjor. Për pasojë, Gjykata e Lartë, Kolegji Civil në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit si të paraqitur jashtë afatit ligjor, ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, sepse nuk ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykatë, si një nga standardet për një proces të

rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese konkludon se kërkesa duhet të pranohet dhe të shfuqizohet si jokushtetues vendimi i kundërshtuar, me qëllim që të krijohet mundësia e shqyrtimit të çështjes nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat ligjore të këtij kolegji.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimin nr.1282, datë 9.11.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Sadushi, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Sokol Berberi

VENDIM

Nr.44, datë 10.6.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 9 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë, të neneve 7, 11, 24 dhe 26 pika 2 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të nenit 27 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe të nenit 12, shkronja ”a” dhe 43, gërma “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja “Për parandalimin e pastrimit të parave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.10, datë 25.2.2004.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT
(Miratuar me vendimin nr.44, datë 10.06.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës
së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, i rregullave për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim parandalimin e përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet e ligjit nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të cilat licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë.

Neni 4

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë e për zbatim të nenit 12, shkronja ”a” dhe 43 shkronja ”c” të ligjit 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të nenit 9 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 7, 11, 24 dhe 26 pika 2 të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe të nenit 27 të ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Neni 5

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Termi “Ligji për parandalimin e pastrimit të parave” do të nënkuptojë ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

KREU II

VIGJILENCA E DUHUR

Neni 6

Procedurat dhe dokumentacioni për identifikimin e klientit

1. Subjektet identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e klientëve për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit sipas kërkesave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe të kësaj rregulloreje.

2. Subjektet hartojnë procedura të brendshme për identifikimin, regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e transaksioneve të klientëve. Këto procedura hartohen në përputhje me kërkesat e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, sidomos të kërkesave lidhur me “Procedurën njithe klientin tënd”, e parashikuar në pikën 21 të nenit 2 të këtij ligji.

3. Subjektet identifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë klientët e tyre dhe pronarët përfitues, si dhe kërkojnë informacione shtesë në rastet kur e gjejnë të arsyeshme.

4. Subjektet bëjnë verifikimin e identitetit të klientit nëpërmjet dokumenteve ligjërish të vlefshme. Dokumentet që paraqiten nga klienti pranë subjektit duhet të jenë origjinale ose fotokopje e notuar. Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose kryerjes së transaksionit/eve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit. Kopjet e këtyre dokumenteve duhet të jenë të vulosura me vulën e subjektit, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.

5. Hapja e një llogarie bankare, edhe në rastet kur ajo do të përdoret për kryerjen e transaksioneve në rrugë elektronike (e-banking account), kryhet vetëm me praninë fizike të klientit.

6. Në rastin e përfaqësimit të klientit nga një person i tretë nëpërmjet një akti përfaqësimi, subjektet kërkojnë të dhëna për identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij, si dhe mbajnë në dosjen e klientit të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej personit të tretë, duke përfshirë dhe origjinalin ose kopjen e notuar të aktit të përfaqësimit. Në raste të tilla, subjektet nuk hapin llogarinë pa praninë fizike të klientit, ndërkohë që veprimet e tjera pas hapjes së llogarisë mund të kryhen nga përfaqësuesi i tij.

7. Subjektet, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi dhe/ose të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të klientit, konsultojnë listën e përditësuar të personave të shpallur si financues të terrorizmit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave sipas ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

8. Subjektet refuzojnë hapjen e llogarisë së klientit dhe nuk hyjnë në marrëdhënie biznesi me të, në rast se nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e tij.

9. Në rast se subjektet në çdo kohë dyshojnë për identitetin e klientit, ato pezullojnë menjëherë çdo veprim me të si dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës, në përputhje me kërkesat për raportim të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

10. Në rastin e klientëve që kanë marrëdhënie biznesi me bankat dhe degët e bankave të huaja, transaksionet për llogari të tyre kryhen në çdo rast nëpërmjet llogarisë së vetë klientit/ëve.

Neni 7

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

Subjektet regjistrojnë në bazën e tyre të të dhënave çdo informacion që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer në emër ose për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni, së bashku me dokumentacionin mbështetës, kryhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në nenin 16, të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 8

Strukturat përgjegjëse të subjekteve

1. Subjektet krijojnë strukturën/at dhe infrastrukturën e nevojshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Subjektet caktojnë një nga drejtuesit ekzekutivë të tyre si person përgjegjës për të përmbushur detyrimet e subjektit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

3. Subjektet njoftojnë Bankën e Shqipërisë për emrin e personit përgjegjës të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në të gjitha rastet që ka ndryshime të këtij personi.

4. Subjektet hartojnë, miratojnë dhe dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

5. Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore/procedura për kategorizimin e klientëve dhe transaksioneve sipas shkallës së rrezikut që ato paraqesin, në përputhje me nenet 8 dhe 9 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave. Për të kryer këtë kategorizim, subjektet mund t'u referohen kritereve të parashikuara në anekset 1 dhe 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

6. Strukturat përkatëse të subjektit vënë në dispozicion të personit përgjegjës, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, mjetet dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e funksionit të tij (si për shembull teknikën e përshtatshme, personelin e mjaftueshëm, një buxhet të arsyeshëm etj.).

7. Degët dhe agjencitë e subjekteve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë regjistrojnë të gjitha veprimet bankare dhe financiare të çdo klienti për shumat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja. Drejtoria e përgjithshme e subjektit ruan dhe mban të gjitha raportimet e bëra nga degët dhe agjencitë e subjektit, si dhe të dhëna të përmbledhura për të gjithë rrjetin e saj në Shqipëri.

8. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trainimit të punonjësve të subjekteve, lidhur me rregulloret dhe procedurat e brendshme të miratuara për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

9. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, informojnë periodikisht punonjësit e këtyre të fundit lidhur me ndryshimin e dispozitave ligjore në fuqi për parandalimin dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për detyrimet e tyre lidhur me zbatimin e këtyre ndryshimeve.

10. Subjektet marrin masa për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, bazuar në kreun III të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave".

11. Subjektet kryejnë monitorime të vazhdueshme të marrëdhënieve të biznesit me klientët e tyre, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë e subjektit për klientin, për objektin e veprimtarisë së tij etj..

12. Punonjësit e subjekteve ruajnë konfidencialitetin për procesin e raportimit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimeve dhe për raportimin e bërë tek autoriteti përgjegjës.

Neni 9

Raportimi tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës sipas formularëve të raportimit dhe afateve të përcaktuara me akt nënligjor nga autoriteti përgjegjës për:

a) të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja;

b) të gjitha transaksionet jo në para fizike, në një shumë të barabartë në vlerë me ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëri-tjetrin.

2. Subjektet, kur kanë arsye të besojnë ose të dyshojnë se transaksioni i kërkuar për t'u kryer nga një klient apo një person tjetër për llogari të klientit, mund të përfshijë pastrim parash ose financim terrorizmi, ia raportojnë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës. Në këto raste, subjektet presin deri në 48 (dyzetë e tetë) orë pas raportimit në autoritetin përgjegjës për udhëzimet e këtij të fundit, nëse duhet ta kryejnë apo jo transaksionin.

3. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transfertat parash ose vlerash, në rastin e transfertave në mbërritje kërkojnë informacione lidhur me dërguesin e parave sipas ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave". Në rast se ky informacion nuk paraqitet i plotë, subjektet refuzojnë kryerjen e transaksionit dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës. Informacioni i plotë identifikues shoqëron transfertën në fazat e lëvizjes së saj nga dërguesi i parë tek përfituesi i fundit.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10 **Kërkesa mbikëqyrëse**

1. Banka e Shqipërisë, mbikëqyr zbatimin e dispozitave të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë raporton tek autoriteti përgjegjës çdo dyshim, çdo informacion ose të dhënë që vlerëson se mund të lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, të cilat i konstaton gjatë procesit të mbikëqyrjes.

3. Banka e Shqipërisë vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Banka e Shqipërisë, për të gjitha shkeljet e evidentuara të cilat mund të klasifikohen si kundravajtje administrative, në bazë të nenit 27 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, informon autoritetin përgjegjës duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë që ka lidhje me konstatimin e shkeljes.

5. Banka e Shqipërisë merr masa mbikëqyrëse ndaj subjekteve të kësaj rregulloreje nëse konstaton se këto të fundit nuk zbatojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 11 **Dispozitë kalimtare**

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, janë të detyruara të kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin, e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

ANEKS I

A) Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut që paraqesin

1. Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut bëhet duke gjykuar mbi mundësinë që subjekti të përdoret nga klienti me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose që klienti të përdorë biznesin e tij ligjor me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.

2. Koncepti i vigjilencës së zgjeruar zbatohet kryesisht për klientët e klasifikuar me rrezik të lartë, të përmendur në nenin 8 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

3. Disa kategori klientësh, që përfshijnë klientë me rrezik të lartë, përcaktohen në listën e mëposhtme, e cila nuk është kufizuese dhe nuk zëvendëson ndonjë detyrim ligjor lidhur me raportimin e klientëve që dyshohen se kryejnë transaksione të dyshimta. Megjithatë, kategorizimi mbetet në gjykimin e vetë subjektit.

Kategori të klientëve:

- a) Personat e ekspozuar politikisht;
- b) Organizatat jofitimprurëse (OJF);
- c) Klientët offshore;
- d) Klientët jorezidentë;
- e) Kazinotë / Lojrat e fatit;
- f) Zyrat e këmbimeve valutore;

- g) Trust-et;
- h) Shoqëritë që merren me import/eksport;
- i) Personat fizikë tregtarë;
- j) Tregtarë floriri dhe metalesh të çmuara;
- k) Nëpunës;
- l) Pensionistë.

B) Klasifikimi i transaksioneve sipas rrezikut që paraqesin

1. Klasifikimi sipas rrezikut bëhet duke gjykuar mbi mundësinë që transaksioni të përdoret nga klienti, me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.

2. Në aneksin II jepen kategori transaksionesh, të cilat mund të klasifikohen me rrezik të lartë, megjithatë kategorizimi mbetet në gjykimin e vetë subjektit.

ANEKS II

Transaksione të dyshimta

1. Subjektet, si një pjesë normale të zhvillimit të aktivitetit të tyre, monitorojnë elementet ose transaksionet individuale të cilat mund të tregojnë fonde të përfshira në procesin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

2. Subjektet informojnë autoritetin përgjegjës për llogari apo transaksion të dyshimtë, pas shqyrtimit të plotë të elementeve që kanë në dispozicion për të vlerësuar sa më mirë transaksionet e kryera.

3. Treguesit e mëposhtëm të dyshimeve të mundshme ose të aktiviteteve jo të zakonata përcaktojnë disa lloje transaksionesh që mund të përbëjnë arsye për monitorim të mëtejshëm. Kjo listë nuk është kufizuese dhe nuk zëvendëson ndonjë detyrim ligjor lidhur me raportimin e transaksioneve të dyshimta ose të pazakonta. Lista e mëposhtme përmbledh një numër transaksionesh që duhet të trajtohen me kujdes nga subjektet si transaksione të dyshimta.

I. Tregues të anomalisë në transaksionet që iu drejtohen të gjitha subjekteve.

f) Transaksione, të cilat duke gjykuar mbi subjektin që kërkon t'i kryejë, shfaqen me një vlerë jo të zakonit ose ekonomikisht të pajustificueshme.

g) Transaksione të së njëjtës natyrë, të përsëritura pranë të njëjtës degë ose të njëjtës agjenci në mënyrë të tillë, që të bëjnë të dyshosh për qëllime të paligjshme.

h) Transaksione të kryera vazhdimisht në emër të të tretëve, që nuk shfaqen asnjëherë personalisht në bankë, kur kjo nuk rrjedh nga kërkesa operative ose organizative evidente të klientit, veçanërisht kur jepen justifikime që nuk mund të vërtetohen (për shembull, sëmundje, punë etj.).

i) Transaksione për të cilat të dhënat janë në mënyrë të dukshme të pasakta ose të paplota, ose të tilla që të bëjnë të dyshosh se synojnë të fshehin me dashje informacione thelbësore, në veçanti që u përkasin subjekteve të interesuara për operacionin.

j) Transaksione me personat e lidhur me bankën, të cilat janë të pajustificuara dhe jashtë natyrës së biznesit apo të pazakonta.

k) Transaksione komplekse, të pazakonta dhe në shuma të mëdha.

l) Transaksione për subjekte të huaja në vende me parajsë bankare ose financiare, nga vende që lejojnë çeljen e llogarive anonime ose që legjislacioni i të cilave nuk konsideron dhe klasifikon si vepër penale pastrimin e parave, veprën penale nga e cila kanë rrjedhur paratë ose pasuritë.

m) Transaksione me shoqëri të njohura si “Off shore”, transaksione me kompani e persona të përfshirë në skandale financiare ose në krime të tjera të rënda.

II. Tregues të anomalisë në transaksionet në cash.

a) Kërkesa të shpeshta dhe për shuma të mëdha të çeqeve kundrejt derdhjeve në cash.

b) Tërheqje ose derdhje të mëdha në cash, të pamotivuara nga aktiviteti i klientit (veçanërisht, kur shumat e derdhura transferohen më pas brenda një intervali të shkurtër kohor ose me të dhëna apo destinacione, që nuk lidhen me aktivitetin normal të klientit).

c) Përzjerje e depozitimeve cash dhe instrumenteve monetare në një llogari në të cilën transaksione të tilla nuk duket të kenë lidhje me përdorimin normal të llogarisë.

d) Kryerja e shumë transaksioneve në të njëjtën ditë, në të njëjtën degë të bankës, por me një përpjekje të dukshme për të përdorur arkëtarë të ndryshëm.

e) Përdorimi i shpeshtë i cash-it në shuma të mëdha për kryerjen e urdhërshirimeve (në dobi të tretëve), pa arsye të pranueshme që lidhen me aktivitetin normal të klientit, veçanërisht nëse operacioni kryhet jashtë vendit.

f) Derdhje ose tërheqje të shpeshta në cash, të kryera në mënyrë të tillë që vlefte e transaksioneve të veçanta të kalojë pa u vënë re, ndërsa ajo e përgjithshme rezulton e konsiderueshme (për shembull, derdhje të pjesshme në disa llogari).

g) Depozitimi apo tërheqja e instrumenteve monetare në shuma të cilat rezultojnë në mënyrë të vazhdueshme nën kufirin e identifikimit apo të raportimit, ndërsa shuma totale rezulton e konsiderueshme veçanërisht nëse instrumentet kanë numër serial të vazhdueshëm.

h) Kryerja e transaksioneve, si derdhje dhe tërheqje të bëra në cash, të ndryshme nga instrumentet e mjetet e pagesës zakonisht të përdorura në aktivitetin ekonomik të ushtruar nga klienti.

i) Transaksione të shpeshta këmbimi në cash, në valuta të tjera për shuma të konsiderueshme, veçanërisht nëse kryhen pa kaluar në llogarinë rrjedhëse.

j) Këmbime të një sasive të madhe kartëmonedhash ose monedhash me kartëmonedha ose monedha të një prerjeje të ndryshme.

k) Blerje të shpeshta të shumave të mëdha të monedhave metalike dhe të kartëmonedhave me vlera komemorativë për qëllime numizmatike.

l) Blerja ose shitja e sasive të mëdha të monedhave, metaleve të çmuara ose të vlerave të tjera, pa një justifikim të arsyeshëm dhe/ose në përputhje me kushtet ekonomike të klientit.

m) Shitblerje të biletave të fituesve të basteve, të llotarive, të biletave të kazinove, të lojrave të fatit, loto sporteve etj..

n) Shitblerje të pasurive (shtëpive, veturave, pajisjeve etj.) të regjistruara mbi vlerën reale të tregut.

o) Subjektet i kushtojnë vëmendje rasteve kur degë të veçanta kërkojnë furnizim në cash ose rasteve, që përfaqësojnë transaksione në cash për vlefte që i tejkalojnë konsiderueshëm kërkesat e zakonshme, në varësi të karakteristikave të zonës dhe të klientelës që i shërbehet.

III. Tregues të anomalisë në transaksionet me letrat me vlerë.

a) Blerja dhe/ose depozitimi i letrave me vlerë për shuma të mëdha, kur kjo nuk përputhet me kushtet financiare të klientit.

b) Arkëtimi në cash ose depozitimi, edhe me garanci të besueshme, i titujve të një vlefte të konsiderueshme, vendi ose të huaja, veçanërisht nëse janë me shpërndarje të kufizuar, kur operacioni duket jonormal në krahasim me karakteristikat e klientit dhe nuk jepet një justifikim i pranueshëm për prejardhjen.

c) Negocimi i letrave me vlerë për arkëtime në cash ose për blerjen e letrave me vlerë të tjera (aksione, obligacione, tituj publikë etj.) pa kaluar operacioni në llogarinë rrjedhëse që përdoret nga klienti.

d) Transferta në vlera më të mëdha se zakonisht, më të shpeshta ose jo tipike të letrave me vlerë të qeverisë, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, të kryera nga një ose disa persona fizikë.

e) Blerja dhe menjëherë pas kësaj ofrimi për shitje i letrave me vlerë të qeverisë para maturitetit, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në madhësi të mëdha dhe në rrethana që duken jo të zakonshme për mënyrat normale të kryerjes së këtij aktiviteti.

f) Madhësi në vëllime të mëdha dhe të përsëritura të tregtimeve jonormale të letrave me vlerë të qeverisë për llogari dhe me shpenzime të një pale të tretë, kundrejt paraqitjes së një prokure ose në emër të personave nën 18 vjeç.

IV. Tregues të anomalisë në transaksionet me jashtë.

a) Transfertat me ose nga jashtë, përfshirë edhe transfertat elektronike, të shumave të mëdha në vlerë ose me urdhërpagesë në cash, veçanërisht kur nuk kalojnë nëpërmjet një llogarie, ose kur karakteristikat e operacionit, përfshirë këtu rastet kur vendi i huaj i origjinës ose i destinacionit të shumave, nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik i zhvilluar nga klienti ose nga rrethana të tjera.

b) Transaksione me filiale ose me degë të institucioneve financiare, të rrethuara nga zona gjeografike të njohura si zona të trafikut të drogës ose si “qendra offshore”, që nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik që kryhet nga klienti.

c) Përdorimi i sistemeve të tjera të financimit tregtar për të transferuar shuma midis shteteve, pa qenë transaksioni përkatës i justifikuar nga veprimtaria e zakonshme ekonomike e kryer nga klienti.

d) Derdhje e shpeshtë e çeqeve të udhëtarëve, e letrave me vlerë ose e instrumenteve të tjera financiare në valutë të huaj, pa justifikime të arsyeshme.

e) Kryerje e disa transfertave në një drejtim të caktuar, transfertat të ndryshme që kanë një përfitues, pavarësisht nga shuma.

V. Tregues të anomalisë në transaksione e shërbime të tjera.

a) Përdorim i përsëritur i kasetave të sigurimit ose i shërbimeve të ruajtjes, ose depozitime të shpeshta dhe tërheqje të plikove të vulosura, të pajustificuara nga aktiviteti dhe zakoni i klientit.

b) Delegimi për të operuar me kasetat e sigurimit tek të tretët, që nuk bëjnë pjesë në bërthamën familjare të mbajtësve ose që nuk janë të lidhur me raporte bashkëpunimi ose të një tipi tjetër, që do të justifikonte këtë delegim.

c) Dhënia e garancive nga ana e të tretëve, joklientë të bankës, as dhe të njohur ndryshe, tek të cilat nuk jepen të dhëna të mjaftueshme për marrëdhëniet me klientin përfitues të besimit apo arsye që justifikojnë dhënien e një garancie të tillë.

d) Kërkesa që i bëhet bankës, nga ana e një klienti, për të dhënë një financim për një subjekt tjetër për të cilin vetë klienti ofron një garanci reale (për shembull, pasuri të paluajtshme ose letra me vlerë) në rast se marrëdhëniet midis klientit të dhënë dhe subjektit tjetër nuk janë të justifikuar.

VI. Tregues të anomalisë në ecurinë e llogarive.

a) Një llogari e hapur nga një subjekt juridik ose një organizatë që ka të njëjtën adresë me subjekte të tjera juridike ose organizata, por për të cilat i njëjti person ose persona kanë të drejtë nënshkrimi, kur nuk ka arsye të dukshme ekonomike ose ligjore për një organizim të tillë (për shembull, individë që shërbejnë si drejtorë kompanish për shumë kompani me zyra qendrore në të njëjtin vend etj.).

b) Një llogari e hapur në emër të një subjekti juridik të krijuar së fundmi dhe në të cilën është depozituar një shumë më e madhe se ajo e pritur, në krahasim me të ardhurat e themeluesve të subjektit.

c) Një llogari për të cilën disa persona kanë të drejtë nënshkrimi, të cilët nuk kanë marrëdhënie midis njëri tjetrit (as lidhje familjare, as biznesi).

d) Një llogari dhe/ose depozitë e hapur në emër të një subjekti juridik, një fondacioni ose një shoqate, të cilat mund të jenë të lidhura dhe/ose të përfshira me një organizatë terroriste dhe që paraqet lëvizje fondesh mbi nivelin e pritshëm të të ardhurave.

e) Një llogari dhe/ose depozitë e hapur në emër të një subjekti juridik, i cili mund të jetë i lidhur dhe/ose i përfshirë në aktivitetin e një shoqate apo fondacioni qëllimi i të cilave është i lidhur me pretendimet apo kërkesat e një organizate terroriste.

f) Llogari të përdorura jo për transaksione normale personale ose aktivitete ekonomike të lidhura me to, por për të marrë ose për të derdhur shuma të mëdha që, në bazë të elementeve në dispozicion, nuk gjejnë justifikim ose lidhje me mbajtësin e llogarisë dhe/ose me aktivitetin e tij.

g) Llogari, të cilat janë pak aktive ose nuk janë aktive pa justifikime të arsyeshme për një kohë të gjatë, dhe fillojnë menjëherë transaksione me shuma të mëdha ose që pak kohë më parë kanë përfituar kreditime të mëdha e të papritura, sidomos nëse ato vijnë nga jashtë.

h) Llogari, të cilat paraqesin një tepëricë aktive të madhe, që nuk përputhet me ecurinë e zakonshme financiare të klientit, veçanërisht nëse ajo është transferuar në llogari jashtë shtetit.

i) Llogari, që përfitojnë një numër të madh derdhjesh për shuma të marra pa justifikime të arsyeshme.

j) Llogari, që tregojnë një lëvizje të pajustificuar nga aktiviteti i zhvilluar prej klientit (për shembull, derdhje të shpeshta të çeqeve, veçanërisht kur në to figurojnë elemente përsëritëse, nga ana e një subjekti, që nuk ushtron aktivitetin e dhënies së financimeve).

k) Konfigurimi, ekonomikisht jonormal, i raporteve që mbahen nga klienti me bankën për shembull, llogari të shumta të hapura pa justifikim pranë së njëjtës bankë, transferime të shpeshta shumash mes llogarive të ndryshme ose barazimi në një kohë të shkurtër mes derdhjeve e tërheqjeve në cash mbi të njëjtën llogari ose depozitë, pranimi i vetëdijshëm i kushteve e taksave të pafavorshme dhe që nuk përputhen me ato të tregut.

VII. Tregues anomalie në sjelljen e klientëve.

a) Klientë që kërkojnë të ristrukturojnë transaksionin, kur konfiguracioni i paraqitur që në fillim përfshin forma identifikimi e regjistrimi ose plotësime hetimesh apo verifikimesh nga ana e personelit të ndërmjetësuesit, ose adoptimi i klauzolave kufizuese të lirisë së qarkullimit të titujve (për shembull, reduktimi i vleftës së transaksionit nën kufijtë e përcaktuar për të shmangur identifikimin).

b) Strukturimi i depozitave përmes degëve të shumta të të njëjtës bankë ose nga grupe individësh të cilët hyjnë në një degë të vetme në të njëjtën kohë.

c) Klientë që refuzojnë ose që pa justifikim të arsyeshëm hezitojnë të japin informacionet e duhura për kryerjen e transaksioneve, të deklarojnë aktivitetet e veta, të paraqesin dokumentacionin kontabël ose të një lloji tjetër, të sinjalojnë marrëdhëniet e mbajtura me subjektet e tjera, të japin informacione, të cilat në rrethana normale do ta bënin vetë klientin të përshtatshëm për të marrë kreditë ose shërbime të tjera bankare/financiare.

d) Klientë në vështirësi ekonomike, që papritur kërkojnë të shlyejnë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e veta me anë të derdhjeve të papritura me një vleftë të madhe, pa një justifikim të dukshëm dhe pa saktësuar origjinën e fondeve.

e) Klientë që evitojnë kontakte direkte me personelin e bankës, duke lëshuar prokurë në emër të të tretëve, në mënyrë të shpeshtë e të pajustificuar.

f) Klientë, që pa justifikim, kanë llogari të shumta dhe kryejnë transaksione të shumave të mëdha në cash mbi secilën prej tyre ose që rezultojnë të kenë, pa shkaqe të arsyeshme, llogari të hapura me shumë institucione financiare në të njëjtën zonë.

g) Klientë që, pa dhënë justifikime të arsyeshme, drejtohen tek një sportel subjekti, që ndodhet larg nga zona në të cilën banojnë ose ushtrojnë aktivitetin e tyre.

h) Klientë që këmbëngulin të mbajnë llogari, që duken se administrohen për llogari të të tretëve (llogari në mirëbesim), (për shembull, llogari që paraqesin lëvizje që nuk lidhen me aktivitetin e zhvilluar nga mbajtësi i llogarisë ose të një vlefte që nuk i korrespondon vëllimit të tij të punës, ose llogari të emërtuara në favor të administratorëve, të vartësve ose të klientëve, të përdorura nga sipërmarrje ose ente për të kryer derdhje ose tërheqje në cash ose nëpërmjet instrumenteve të tjera financiare).

i) Klientë ose përfaqësues të tyre që paraqesin dokumente identifikimi me origjinë të dyshimtë.

j) Klientë që japin si adresë të tyre një adresë të një personi të tretë.

k) Klientë që hapin disa llogari dhe kryejnë transferta të shpeshta të fondeve midis tyre.

l) Klientë që kryejnë transaksione me partnerë jo të zakonshëm.

m) Mosjustifikimi me dokumentacion përkatës i veprimeve të kryera nga jorezidentët me llogaritë e hapura pranë subjekteve.

VIII. Tregues anomalie në transaksionet e transfertave.

a) Transferta të urdhëruara në shuma të vogla, në përprjekje të dukshme për të mënjанuar kërkesat për identifikim apo raportim.

b) Transferta drejtuar apo përfituar nga një individ ku informacioni për iniciuesin e transfertës, ose personin për të cilin transaksioni është realizuar, nuk është dhënë në transfertë, ndërsa është e nevojshme përfshirja e një informacioni të tillë për kryerjen e transfertës.

c) Përdorimi i llogarive të shumta personale apo biznesi ose i llogarive të organizatave jofitimprurëse apo bamirësie për të grumbulluar dhe më pas për t'i transferuar fondet menjëherë ose pas një periudhe të shkurtër te një numër i vogël përfituesish të huaj.

d) Transaksione të këmbimit valutor që janë realizuar në përfitim të një klienti nga një palë e tretë, të pasuara nga transferata të fondeve në vende të cilat nuk kanë lidhje të dukshme biznesi me klientin ose vendeve që paraqesin shqetësime/probleme specifike.

IX. Tregues anomalie të karakteristikave të klientit ose të biznesit të tij.

a) Fondet e krijuara nga një biznes që zotërohet nga individë të të njëjtit vend origjine ose përfshirja e shumë individëve të së njëjtës origjinë nga vende që paragjeshin problem/shqetësim specifik duke vepruar në interes të llojeve të ngjashme të bizneseve.

b) Adresë e përdorur bashkërisht për individë të përfshirë në transaksione cash, veçanërisht kur adresa është edhe një vend biznesi dhe/ose nuk duket të korrespondojë me profesionin e deklaruar (për shembull student, i papunë, i vetëpunësuar etj.).

c) Profesionin e deklaruar i personit që kryen transaksionin nuk është në përputhje me nivelin ose llojin e aktivitetit (për shembull, një student ose një individ i papunë i cili merr ose dërgon një numër të madh transfertash, ose i cili bën tërheqje maksimale ditore në cash në vende të ndryshme në një shtrirje gjeografike të gjerë).

d) Për organizatat jofitimprurëse ose të bamirësisë, transaksionet financiare për të cilat nuk duket të ketë qëllim logjik ekonomik ose në të cilat nuk duket të ketë lidhje midis aktivitetit të deklaruar të organizatës dhe palës tjetër në transaksion.

e) Një kasetë sigurie është hapur në emër të një subjekti tregtar kur aktiviteti i biznesit i klientit është i panjohur ose një aktivitet i tillë nuk duket të justifikojë përdorimin e kutisë së sigurisë.

f) Mospërputhje të pashpjeguara të krijuara nga procesi i identifikimit ose verifikimit të klientit (për shembull, në lidhje me vendin e mëparshëm apo aktual të rezidencës, vendin e lëshimit të pashaportës, vendeve të vizituara sipas pashaportës, dhe dokumenteve të dhëna për të vërtetuar emrin, adresën dhe datën e lindjes).

X. Transaksione të lidhura me vende që paraqesin shqetësime / probleme.

a) Transaksione që përfshijnë këmbim të monedhës së huaj që pasohen brenda një kohe të shkurtër nga transferata për në vende me situata/gjendje/probleme të veçanta (për shembull, vende të përcaktuara nga autoritetet vendase ose/dhe FATF-i si vende dhe territore jobashkëpunuese etj.).

b) Depozitimet që pasohen brenda një kohe të shkurtër nga transferime të fondeve, veçanërisht në ose nëpërmjet vendeve me situata/gjendje/probleme të veçanta (për shembull, vende të përcaktuara nga autoritetet vendase ose/dhe FATF-i si vende dhe territore jobashkëpunuese etj.).

c) Një llogari biznesi nëpërmjet të cilës realizohet një numër i madh transfertash hyrëse ose dalje dhe për të cilat nuk duket të ketë logjikë biznesi ose qëllim tjetër ekonomik, veçanërisht kur ky aktivitet është për në, nëpërmjet ose nga vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.

d) Përdorimi i shumë llogarive për të grumbulluar dhe më pas për t'i dërguar fonde një numri të vogël përfituesish të huaj, individëve dhe bizneseve, veçanërisht kur këto janë në vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.

e) Një klient merr një instrument kredie ose merr pjesë në transaksione financiare tregtare që përfshijnë lëvizje të fondeve drejt ose nga vende me situata/gjendje/probleme të veçanta ku nuk duket të ketë arsye logjike biznesi për të vepruar me këto vende.

f) Hapja e llogarive të institucioneve financiare nga vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.

g) Dërgimi ose marrja e fondeve nga transferata ndërkombëtare nga dhe/ose për në vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.

XI. Pastrimi i parave nëpërmjet përfshirjes së punonjësve të bankës.

a) Një ndryshim i madh në kushtet e jetesës së një punonjësi të bankës i pamotivuar, që shfaq menjëherë elementet e një mënyre të shtrenjtë jetese.

b) Një ndryshim në kryerjen e detyrave, si rritje e menjëhershme e madhësisë së transaksioneve në cash.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.45, datë 10.6.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË
SIPAS SISTEMIT RAPORTUES TË UNIFIKUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” nenit 43, shkronja “c”, nenit 27, nenit 58, nenit 70 pika 1 dhe nenit 71 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 47 pika 4 dhe nenit 126 pika 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, neneve 42 dhe 50 të ligjit nr.8782 datë 03.05.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit” i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet i Departamenti i Statistikës dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI
YLLI MEMISHA

KRYETARI
ARDIAN FULLANI

RREGULLORE
MBI RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË SIPAS SISTEMIT
RAPORTUES TË UNIFIKUAR

(Miratuar me vendimin nr.45, datë 10.06.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe afateve të raportimit në Departamentin e Statistikës së Bankës së Shqipërisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, si dhe i rregullave për administrimin e këtyre raportimeve në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje të:

1. nenit 47, pika 4 dhe nenit 126, pika 4 të ligjit, nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;

2. nenit 27, nenit 58, nenit 70 pika 1 dhe nenit 71 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

3. neneve 42 dhe 50 të ligjit nr.8782, datë 03.05.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”;

4. vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr.95, datë 24. 12.2008 për miratimin e “Metodologjisë së raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare”, si dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;

5. akteve nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administrimin e rrezikut, të cilat përcaktojnë detyrime për raportim nga bankat dhe degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, si dhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Sistemi Raportues i Unifikuar për bankat – SRU apo Sistemi Raportues”- përbën tërësinë e formularëve të raportimit të bankave.

2. “Sistemi Raportues i Unifikuar për degët e bankave të huaja – SRU apo Sistemi Raportues” - përbën tërësinë e formularëve të raportimit të degëve të bankave të huaja.

3. “Sistemi Raportues i subjekteve financiare jobanka” – përbën tërësinë e formularëve të raportimit të subjekteve financiare jobanka.

4. “Sistemi Raportues i Shoqërive të Kursim-Kreditit dhe Unioneve të tyre” – përbën tërësinë e formularëve të raportimit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.

5. “Subjekte raportuese” – janë bankat dhe degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, si dhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

6. “Kërkesa rregullatore” - janë aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë ku përcaktohen metodat e llogaritjes dhe nivelet e lejuara për administrimin e rreziqeve.

KREU II SISTEMET RAPORTUESE

Neni 4

Qëllimi i sistemeve raportuese

Qëllimi i sistemeve raportuese është marrja e informacionit të standardizuar nga subjektet raportuese si dhe përpunimi i tyre për efekte të mbikëqyrjes bankare dhe përgatitjes së statistikave monetare e financiare.

Neni 5

Forma e raportimit

1. Sistemet raportuese përbëhen nga formularë të ndryshëm, të detyrueshëm për t'u plotësuar dhe për t'u paraqitur në Bankën e Shqipërisë nga subjektet raportuese.

2. Formularët hartohen në mënyrë që të mbledhin informacionin e nevojshëm për Bankën e Shqipërisë dhe grupohen në disa grupe sipas qëllimit, të cilit i shërbejnë.

a) Në grupin e parë bëjnë pjesë formularët bazë që janë : formulari i aktivitetit, formulari i pasivitetit, pasqyrat e fitimit / humbjeve dhe formulari i zërave jashtë bilancit.

b) Në grupin e dytë bëjnë pjesë formularët që kërkojnë informacione për të vlerësuar përmbushjen e kërkesave rregullatore të Bankës së Shqipërisë.

c) Në grupin e tretë bëjnë pjesë formularët që kërkojnë informacione për hartimin e statistikave dhe treguesve të tjerë, të nevojshëm për plotësimin e funksioneve të aktiviteteve të Bankës së Shqipërisë.

Neni 6

E drejta për ndryshime

1. Ndryshimet në sistemet raportuese mund të propozohen prej njërit nga departamentet e mëposhtme:

a) Departamenti i Mbikëqyrjes;

b) Departamenti i Politikës Monetare;

c) Departamenti i Operacioneve Monetare;

d) Departamenti i Stabilitetit Financiar së bashku me Departamentin e Statistikës.

2. Propozimet e mundshme për ndryshime në sistemet raportuese paraqiten për miratim në Këshillin Mbikëqyrës jo më shpesh se një herë në tre muaj.

Neni 7

Periodiciteti i raportimeve

1. Raportimet nga bankat dhe degët e bankave të huaja sipas kësaj rregulloreje kryhen në periudha 1 (një) muajore, 3 (tre) muajore, 6 (gjashtë) muajore dhe vjetore.

2. Raportimet nga subjektet financiare jobanka sipas kësaj rregulloreje kryhen periodikisht çdo 3 (tre) muaj.

3. Raportimet nga shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre sipas kësaj rregulloreje kryhen në periudha 3 (tre) muajore dhe 6 (gjashtë) muajore.

4. Periodiciteti i raportimit sipas formularëve përcaktohet në sistemet raportuese përkatëse.

Neni 8

Afati i raportimit

1. Afati për dorëzimin në Bankën e Shqipërisë të sistemit raportues për bankat dhe degët e bankave të huaja, është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike pas mbylljes së periudhës raportuese.

2. Afati për dorëzimin në Bankën e Shqipërisë të sistemit raportues të subjekteve financiare jobanka, është jo më vonë se 40 (dyzet) ditë pas mbylljes së tremujorit përkatës.

3. Afati për dorëzimin në Bankën e Shqipërisë të sistemit raportues të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre është jo më vonë se 50 (pesëdhjetë) ditë pas mbylljes së tremujorit, gjashtëmujorit apo fundit të vitit.

4. Afatet e raportimit të përcaktuara sipas kësaj dispozite do të konsiderohen të përmbushura vetëm pasi raportimet të vlerësohen si të sakta nga Departamenti i Statistikës, pas kryerjes prej këtij të fundit të kontrollit për këtë qëllim.

Neni 9 Administrimi

1. Të gjitha sistemet raportuese administrohen nga Zyra e Administrimit të Raportimeve pranë Departamentit të Statistikës,.

2. Procedurat e punës për administrimin dhe kontrollin e raportimeve përcaktohen në manualin “Administrimi i SRU-së në Zyrën e Administrimit të Raportimeve” dhe manualin “Kriteret e Kontrollit për Sistemin Raportues të Unifikuar – SRU”, të cilat miratohen nga Administratori përkatës.

Neni 10 Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional

Punonjësit e Bankës së Shqipërisë që kanë për detyrë funksionale administrimin e sistemeve raportuese janë përgjegjës për ruajtjen e sekretit profesional, shtetëror dhe atij bankar jopublik, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror” i ndryshuar, të rregullores “Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë”, si dhe të udhëzimit “Mbi rregullat e përdorimit dhe klasifikimin e informacionit jopublik në Bankën e Shqipërisë”.

KREU III MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Neni 11 Detyrimet e subjekteve raportuese

1. Subjektet raportuese dërgojnë informacionin në afatet dhe në formën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në këtë rregullore, në përputhje me sistemet raportuese të miratuara.

2. Raportimi nga subjektet raportuese sipas kësaj rregulloreje bëhet në formë shkresore dhe në formë elektronike.

3. Shkresa përcjellëse e dorëzimit në Bankën e Shqipërisë të sistemit raportues për bankat dhe degët e bankave të huaja duhet të jetë e nënshkruar nga administratori, i cili ka në varësi njësinë që merret me plotësimin e sistemit raportues.

4. Shkresa përcjellëse e dorëzimit në Bankën e Shqipërisë të sistemit raportues të subjekteve financiare jobanka dhe të shoqërive të kursim-kreditit e unioneve të tyre, duhet të jetë e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i tyre.

5. Çdo fletë e plotësuar e formularit të sistemeve raportuese duhet të përmbajë gjeneralitetet dhe nënshkrimin e specialistit të subjektit përkatës raportues, që përgatit këtë raportim.

Neni 12

Përgjegjësia për saktësinë e informacionit

1. Subjektet raportuese marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar saktësinë e të dhënave të raportuara dhe janë përgjegjëse për saktësinë e tyre.

2. Nëse subjektet raportuese identifikojnë pasaktësi në të dhënat e raportuara pas dërgimit të tyre në Bankën e Shqipërisë, ato janë të detyruara të njoftojnë menjëherë Departamentin e Statistikës së Bankës së Shqipërisë lidhur me këto pasaktësi.

3. Nëse Banka e Shqipërisë konstaton kryesisht se të dhënat e raportuara janë të pasakta, ajo urdhëron korrigjimin e tyre nga subjektet përkatëse raportuese si dhe përsëritjen e raportimit pas korrigjimeve.

4. Në zbatim të pikës 3 të këtij neni subjektet raportuese kryejnë korrigjimet përkatëse dhe i raportojnë ato brenda ditës pasardhëse të punës, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 13

Masat ndëshkimore

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë mund të marrë ndaj administratorëve përgjegjës të subjekteve raportuese ose ndaj vetë këtyre të fundit, masat mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.8782 datë 03.05.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

VENDIM

Nr.46, datë 10.06. 2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, të nenit 12 shkronja “a”, të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 57 pika 2, nenit 58 pika 1, shkronja “b”, nenit 63 dhe nenit 64 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, miratuar me vendimin nr. 31, datë 30.04.2008, ndryshuar me vendimin nr.72, datë 07.10.08 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 7, shtohet pika 7 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Përjashtim nga kufizimi i pikës 6 të këtij neni bëjnë ekspozimet e bankës ndaj një apo më shumë filialeve të vetë bankës ose të shoqërisë mëmë, kur këto filiale plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1.1 ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

1.2 licencohen e mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë;

1.3 kryejnë vetëm me klientë/persona që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën një nga veprimtaritë e mëposhtme:

- a) të gjitha format e kredidhënies,
- b) qiranë financiare,
- c) faktoringun.

2. Në nenin 8, shkronja “b”, pas pikës (vi) shtohet pika (vii) me përmbajtjen e mëposhtme:

“Garancitë e drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara të lëshuara nga bankat dhe institucionet e tjera financiare që veprojnë në vendet e OECD-së, të cilat garantojnë shprehimisht të drejta/kredi ndaj klienteve/personave që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në nenin 8, shkronja “b”, pika (vii) rinumërohet si pika (viii).

4. Në nenin 10, pika 1, shtohet shkronja “c”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Formularin e raportimit nr. 4 në zbatim të kërkesave të nenit 7, paragrafi 4 të rregullores”.

5. Formularët nr. 1 dhe nr. 2 ” të përcaktuar në nenin 10, pika 1, shkronja “a” zëvendësohen me formularët respektivë bashkëngjitur kësaj rregulloreje (SRU respektivisht forma 18 dhe 18/1”).

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Statistikave për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU) që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Ardian Fullani

Formulari nr.1

MATJA E KONTROLLI I EKSPOZIMEVE MAKSIMALE	
Kapitali rregullator	Shumat
kapitali rregullator në fillim të periudhës	
shtesat (+)/pakësimet (-) gjatë periudhës	
kapitali rregullator në fund të periudhës	
(10%) e kapitalit rregullator	
(20%) e kapitalit rregullator	
(700%) e kapitalit rregullator	

Ekspozimet e mëdha

Klienti/Personi dhe grup klientët e lidhur	Ekspozimet per kliente/ grup kliente te lidhur	Garancitë/ kolateralet e zbritshme	Ekspozimet per kliente/ grup kliente te lidhur pas zbritjes se garancive/kolateraleve	Ekspozime per kliente/grup kliente te lidhur te reduktuar		Ekspozimet
				me 20%	me 50%	
1	2	3	4 = 2 - 3	5 = 4*20/100	6 = 4*50/100	7 =4,5,6
Totali i ekspozimeve të mëdha		0.0		0.0	0.0	

Formulari nr.2

MATJEA E KONTROLLI I EKSPOZIMEVE MAKSIMALE	
Kapitali rregullator	Shumat
kapitali rregullator në fillim të periudhës	
shtesat (+)/pakësimet (-) gjatë periudhës	
kapitali rregullator në fund të periudhës	
(10%) e kapitalit rregullator	
(25%) e kapitalit rregullator	

Ekspozimet e mëdha

Klientë/Persona të lidhur me bankën	Ekspozimet për kliente/ personat e lidhur me banken	Garancitë/ kolateralet e zbritshme	Ekspozimet për kliente/ personat e lidhur me banken pas zbritjes së garancive/kolateralëve	Ekspozime për kliente/persona të lidhur me banken të reduktuar		Ekspozimet
				më 20%	më 50%	
1	2	3	4 = 2 - 3	5 = 4*20/100	6 = 4*50/100	7=4,5,6
Totali i ekspozimeve të mëdha		0.0		0.0	0.0	

Ne tabelen e ekspozimeve te medha do te raportohen te dhena per ato kliente/grup klientesh apo persona te lidhur me banken ekspozimi i te cileve pas zbritjes se garancive/kolateralit dhe reduktimeve respektive, rezulton i barabarte ose me i madh se 10 % e kapitalit rregullator te bankes

1. Në kollonën 1 – banka tregon emrin e klientit

2. Në kollonën 2 – jepet vlere e ekspozimit per cdo klient/grup kliente te lidhur /person te lidhur me banken përpara zbritjes së garancive/kolateralit dhe reduktimit.

3. Në kollonën 3 – jepet totali i garancive apo kolateraleve të marra për cdo klient./grup kliente te lidhur/person te lidhur me banken.

4. Në kollonën 4 – jepet vlere e ekspozimit per cdo klient./grup kliente te lidhur/person te lidhur me banken pas zbritjes se garancive apo kolateraleve.

5. Në kollonën 5 – jepet vlere e ekspozimit per cdo klient/grup kliente te lidhur/person te lidhur me banken te reduktuar me koeficientin 20 %.

6. Në kollonën 6 – jepet vlere e ekspozimit per cdo klient/grup kliente te lidhur/person te lidhur me banken te reduktuar me koeficientin 50 %.

7. Në kollonën 7 – jepet ekspozimi total për cdo klient/grup kliente te lidhur/person te lidhur me banken, që rezulton i barabarte ose me i madh se 10 % të kapitalit rregullator të bankës (ekspozimit te cdo klienti/grup klientesh te lidhur/personi te lidhur me banken, i eshte zbritur garancia/kolateriali përkatës dhe jane bere reduktimet respektive me 20 dhe 50 per qind te ekspozimit).

8. Rreshti “Totali i ekspozimeve të mëdha” – jepet shuma e ekspozimeve të mëdha për të gjithë klientet e raportuar.

Formulari nr.4 Ekspozimet ndaj personave me nje marredhenie te vecante me banken

Personat me nje marredhenie te vecante me banken	Ekspozimet ndaj personave me nje marredhenie te vecante me banken			
	Ekspozimet	Kolaterali	Kolaterali sipas percaktimit ne rregullore	Pjesa qe zbritet nga kapitali rregullator
	1	2	$3=140\% \cdot 1$	$4=3-2$ nqs $3>2$
Shuma qe zbritet nga kapitali rregullator				0

Shenim :

Per plotesimin e formularit do te zbatohen kerkesat e nenit 7, paragrafi 4 e rregullores per "Administrimin e rrezikut nga ekspozimet e medha te bankave".

VENDIM
Nr.47, datë 10.6. 2009

**PËR NJË SHITESË NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT
TË KREDISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe nenit 57 pika 2, neneve 58 dhe 61 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë” miratuar me vendimin nr.52, datë 14.07.2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme :

...Në nenin 4, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me përmbajtje si vijon :

c) kur kredimarrësi nuk është i mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit nëpërmjet një produkti derivativ (instrumente derivative), që përdoret për këtë qëllim dhe që ofron kushte të përshtatshme mbrojtjeje.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI
Ylli Memisha

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.858, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “GLOB TV”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit fizik z. Bujar Hoxhaj, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në rrethin e Beratit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.859, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “REX”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Rex Mundi” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analoge për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në qarkun e Korçës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.860, datë 12.6.2009

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI
PËR RADION PRIVATE VENDORE “B-94”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Dynamic Sound” sh.p.k., për radion vendore “B-94”, sipas licencës nr.068/FML për të penetruar me sinjal në rrethin Tiranë-Durrës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.861, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO 1”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “MEDIA 99” sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor, në fushën e transmetimeve analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në rrethin Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.862, datë 12.6.2009

PËR MOSDHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO 108”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat vendor subjektin fizik z.Martin Leka, pasi shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:
 - Forma ligjore e subjektit nuk është në përputhje me kriterin e përcaktuar në nenin 20 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Licenca për transmetim vendor në zonat urbane me mbi 200 000 banorë nuk u jepet personave fizikë”.
 - Subjekti nuk ka bërë ngurtësimin e fondit prej 500 mijë lekësh, sipas kriterit.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.863, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR RADION PRIVATE VENDORE “SCAN”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të zonave dhe frekuencave të lira të shpallura publikisht sipas vendimit nr.850 të KKRT-së, datë 24.4.2009, si dhe kërkesës së subjektit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “MEDIASAT” sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor, në fushën e transmetimeve analoge për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të penetruar me sinjal në rrethin Tiranë-Durrës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.864, datë 12.6.2009

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT
KABLLOR “TV KOMBI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” si dhe Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Kombi” sh.p.k., për televizionin kabllor privat “TV Kombi”, sipas licencës nr.006/RTV Kabllor, në qytetin e Patosit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.865, datë 12.6.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV ALPO”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat “TV Alpo”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 7.6.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.866, datë 12.6.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR LUSHNJA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV Kabllor Lushnja”, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.6.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.868, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR PLATFORMËN PRIVATE NUMERIKE SATELITORE “TRING TV”
SUBJEKTIT “TRING TV” SHA

Në mbështetje të ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “TRING TV” sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si platformë private numerike satelitore, me afat 10-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë

Hyri në shtyp më 17.7.2009
 Doli nga shtypi më 18.7.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë